



PASQYRA E KURSIT

Financimi privat me pjesëmarrje në kapital

21 tetor 2019



EU-REPARIS financohet nga Bashkimi Evropian dhe është pjesë e EDIF të BB-së



WB EDIF

Western Balkans Enterprise Development and Innovation Facility



Qasja e kursit

Kursi është strukturuar në 10 module, ku secili trajton një temë të rëndësishme.

Prezantimi i koncepteve çimentohe me raste studimore nga realiteti dhe me ushtrime.

Secili modul ka një minitest në mbyllje të tij.

Pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri solide mbi ndikimin dhe rolin që ka financimi privat me pjesëmarrje në kapital, si formë financimi, administrimi dhe drejtimit të brendshëm të shoqërisë.

Moduli 1 - Investimi me pjesëmarrje në kapital dhe kapitali privat

Informacion i përgjithshëm

Një pasqyrë e dinamikave të tregut të kapitalit të riskut dhe investimit me pjesëmarrje në kapital dhe i mënyrës se si administruesit e fondeve i identifikojnë investimet.

Objektivi:

Pasqyrë e tregut të kapitalit privat



Kërkesat më kryesore të investorëve të kapitalit dhe rritjes



Procesi i verifikimit të investorëve privatë me pjesëmarrje në kapital



Identifikimi i shoqërive për investim



Ku dallojnë 22.000 NVM-të në të cilat kanë investuar firmat e investimit me pjesëmarrje në kapital në Evropë, nga 20 milion NVM-të e tjera evropiane?

Materiale ndëraktive

Vështirësitë në shoshitje

Lista e kontrollit për shoshitje

Moduli 2 - Përdorimi i fondeve

Informacion i përgjithshëm

Një prezantim i përgjithshëm se si do t'u pëlqente investorëve që të përdreshin fondet e investuara dhe se si mund të reagojnë shoqëritë duke prezantuar një plan të mirëmenduar, përfshirë tepricat monetare për shoqëritë në fazë rritjeje dhe kur do të nevojitet likuiditet i mëtjshëm. Do të trajtohet edhe blerja e shoqërive të vogla si një formë e përdorimit të fondeve që haset shpesh në investimin me pjesëmarrje në kapital, si një zgjidhje më e shpejtë se rritja organike.

Objektivi:

Përcaktimi i përdorimit të fondeve: injektim i fondeve ose shpenzim i fondeve



Shpenzimet kapitale në dallim nga ulja e borxhit në dallim nga kapitali qarkullues



Blerja e shoqërive të vogla



Investitorët me pjesëmarrje në kapital duan të dinë dhe të kenë në kontroll mënyrën se si shpenzohen paratë e tyre. Blerja e shoqërive të vogla është një mënyrë tërheqëse për t'u rritur, por ka risqe që duhen menaxhuar.

Materiale ndëraktive

Artemis: sinergjia e blerjeve

Moduli 3 – Ngjallja e interesit të investitorit

Informacion i përgjithshëm

Do të përgatitet një prezantim i shpejtë në formën e videos.

Objektivi:

Praktikat më të mira në krijimin e një prezantimi tërheqës për investim



Si të krijosh një «prezantim ashensori» në formë video 90 sekonda të gjatë



Vëmendja është e kufizuar, sidomos në rastin e njerëzve me para. Duhet të përqendrohesh në atë që ka nevojë të dijë dëgjuesi, jo në atë që doni të thoni ju.

Materiale ndëraktive

Raste studimore –
Analizimi i prezantimeve
të ndryshme tërheqëse
nga rajoni

Video: Çfarë është
«prezantimi i
ashensorit»

Shembull: FinTech:
koncepti i kasave të
sigurisë

Moduli 4 - Negocimi i investimeve me pjesëmarrje në kapital privat

Informacion i përgjithshëm

Qasja për negocimet është çështje stili vetjak, faktorësh kulturorë dhe qasjesh specifike të investitorëve me pjesëmarrje në kapital. Për t'i konkretizuar konceptet, në seancën ballë për ballë do të zhvillohet një simulim negociatash.

Objektivi:

Analizimi i stilit negociues



Specifikat kulturore në negocime



Vendosja e objektivave dhe planifikimi në procesin e negocimit dhe qasja që ndjekin investitorët në negocime: situata ku fitojnë të dyja palët



Fondet e investimit me pjesëmarrje në kapital janë negociues të zotë. Do të mund të luani një rol konstruktiv nëse i kuptoni më mirë teknikat e negocimit.

Materiale ndëraktive

Ushtrimi 10.1 – Vetëtestim për negocimin
Do të kryeni një provim dhe do të konstatooni se çfarë lloj negociuesi jeni

Moduli 5 – Pasqyrat financiare dhe analiza financiare

Informacion i përgjithshëm

Një përmbledhje e elementeve thelbësore për të kuptuar pasqyrat financiare të shoqërisë, siç janë performanca financiare, pozicioni financiar dhe flukset monetare. Një përmbledhje e raporteve financiare, si përlllogariten dhe çfarë na tregojnë. Si kryhet analiza financiare duke i vënë në rregull llogaritë dhe duke bërë parashikime të besueshme.

Objektivi:

Analiza e pasqyrave
financiare



Përdorimi i raporteve



Parashikimi i pasqyrave financiare



Fitimi kontabël manipulohet me lehtësi; disa teknika bazë të analizës do t'u japin mundësi pjesëmarrësve t'i dallojnë shpejt problemet kryesore. Kur di si të përdorësh disa raporte të rëndësishme financiare, mund të krijosh një ide të menjëhershme për shoqërinë.

Materiale ndëraktive

Llogaritja e raporteve financiare
nga paketa e pasqyrave

Moduli 6 – Vlerësimi i shoqërisë

Informacion i përgjithshëm

Informacion i shkurtër se si vlerësohen shoqëritë nga investitorët me pjesëmarrje në kapital dhe investitorët e kapitalit të riskut, në mënyrë që mirëkuptimi i ndërsjellë ta zvogëlojë riskun e dështimit të marrëveshjeve për shkak të problemeve në vlerësim

Objektivi:

Përmbledhje mbi flukset monetare të skontuara



Shembull i punuar nga mjedisi i EQL-CIS

Përmbledhje mbi vlerësimin relativ



Qasja për vlerësimin që bën investitori privat me pjesëmarrje në kapital e bazuar te strategjia e daljes

Gjetja dhe manipulimi i informacioneve në tregjet e zhvilluara dhe tregjet e reja



Parashikimi dhe modeli në investimin me pjesëmarrje në kapital

Nuk mund të negociohet me fondin e investimit me pjesëmarrje në kapital, pa kuptuar qasjen e tij për vlerësimin e cila orientohet nga dalja nga pronësia dhe pa kuptuar se si i përdor instrumentet e ndryshme financiare.

Materiale ndëraktive

Vlerësim i ofertës për pjesëmarrje në kapital, i thjeshtë

Ushtrim vlerësimi sipas metodës së flukseve monetare të skontuara

Vlerësim i ofertës për pjesëmarrje në kapital, i ndërlikuar

Ushtrim vlerësimi relativ

Vlerësimi brenda strukturave të marrëveshjeve

Vlerësimi i orientuar nga dalja nga pronësia

Video - Çfarë është kosto mesatare e ponderuar e kapitalit?

Moduli 7 - Verifikimi i kapitalit privat

Informacion i përgjithshëm

Shpesh sipërmarrësit dhe ofruesit e shërbimeve të tyre nuk i kuptojnë mirë nevojat që kanë investitorët për të bërë verifikimin e duhur. Ky modul u jep mundësi të ndërveprojnë duke e kuptuar këtë nevojë dhe duke parë përfitimet që sjell kryerja e verifikimit të duhur nga ana e shitësit. Moduli jep edhe orientime mbi praktikat më të mira të raportimit për ofruesit e shërbimeve.

Objektivi:

Verifikimet e duhura të kryera nga shitësi përpara investimit



Verifikimet e duhura të kryera nga shitësi si “udhërrëfyes” për të lehtësuar verifikimet e kryera nga blerësi



Menaxhimi dhe ndarja e kostove të verifikimeve të duhura



Konsulentët që merren me verifikimet e duhura dhe ndërmjetësimin e transaksionit



Praktika më e mirë në raportimin e verifikimit të duhur



Kush mendon se mund t'i fshehë diçka investitorit me pjesëmarrje në kapital gënjen veten dhe çon dëm kohën e të gjithëve. Kryerja e verifikimeve të duhura nga shitësi janë mënyra më e mirë për të ngjallur interes dhe për të maksimizuar mundësinë për të pasur sukses.

Materiale ndëraktive

Materiale në mbështetje të verifikimeve të duhura – tabelë me listë kontrolli për kryerjen e verifikimeve të duhura






Rast studimor mbi parregullsi në verifikimet e duhura

Moduli 8 – Strukturimi i marrëveshjes

Informacion i përgjithshëm

Investitorët shpesh përdorin struktura komplekse të marrëveshjeve. Nëse i kupton mirë aspektet kryesore dhe arsyet e këtyre, atëherë rriten mundësitë për të arritur një marrëveshje të suksesshme.

Objektivi:

Si i qasen strukturimit të marrëveshjes fondet e investimit me pjesëmarrje në kapital 	Përse u pëlqen kompleksiteti në marrëveshje administruesve të fondeve të investimit me pjesëmarrje në kapital 	Instrumentet financiare të përdorura 	Pengesat kryesore ndaj arritjes së një marrëveshjeje të suksesshme 	Aspektet e financimi me pjesëmarrje në kapital: të drejtat e vetos, mekanizmi flipover, llogaritë me kusht 
---	---	---	--	--

Vëmendja është e kufizuar, sidomos në rastin e njerëzve me para. Duhet të përqendroheni në atë që ka nevojë të dijë dëgjuesi, jo në atë që doni të thoni ju.

Materiale ndëraktive

Rast studimor 7.1 –
Kauçuku afrikan

Rast studimor 7.2 –
Ristrukturimi i Cleantech

Ushtrimi 7.3 –
Dilema 50:50 e sipërmarrësit

Ushtrimi 7.4 –
Dilema e ofertës private për pjesëmarrje
në kapital

Moduli 9 – Fleta e kushteve

Informacion i përgjithshëm

Fleta e kushteve shërben si “udhërrëfyes” për arritjen e çdo marrëveshjeje. Të kuptuarit e objektivave të saj dhe nxjerrja e një flete kushtesh të strukturuar mirë, me mekanizma përshtatjeje, përbën bazën e çdo marrëveshjeje.

Objektivi:

Përdorimet e fletës së kushteve dhe sekuenca në procesin e investimit



Shembull për ilustrim: shikimi i një flete tip kushtesh dhe i klauzolave tipike të saj – aspektet detyruese dhe ato jo detyruese



Mosmarrëveshjet dhe ndërgjygjësia në investimin me pjesëmarrje në kapital



Fleta e kushteve është nyja kryesore e procesit të investimit me pjesëmarrje në kapital. Nëse bëhet kjo e saktë, atëherë edhe palët arrijnë të bien dakord.

Materiale ndëraktive

Ushtrim – Hartimi i një flete kushtesh për CompCo

Moduli 10 – Drejtimi i brendshëm & administrimi pas investimit

Informacion i përgjithshëm

Pas investimit, ndodhin ndryshime të konsiderueshme në mënyrën se si bëhet menaxhimi financiar. Është me rëndësi të kuptohen që më përpara këto, si qasja e investuesve me pjesëmarrje në kapital ndaj pronësisë, ndaj këshillit të administrimit dhe ndaj zbatimit të sistemeve financiare.

Objektivi:

Modeli i shtimit të vlerës së investimit me pjesëmarrje në kapital



Drejtimi i brendshëm i shoqërisë pas investimit me pjesëmarrje në kapital



Monitorimi dhe rritja e vlerës pas investimit



Partneri që investon në kapital nuk është bankier apo partner pasiv. Ai i fut hundët drejt e në biznes dhe nuk largohet. Kjo kërkon ndryshim të mentalitetit nga sipërmarrësi, çka është diçka e vështirë.

Materiale ndëraktive

Lexim – Investim në kapital – GlobalNet

Lexim – Zgjerim – DCM

Lexim – Blerja e kuotës kontrolluese – Maktel

Matrica e drejtimit të brendshëm të shoqërisë

Ushtrim – Monitorimi i portofolit